

KLIMA E INVESTIMEVE 2018

MBI INSPEKTIMET

MBLEDHJE E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE
29 JANAR 2019

PËRMBAJTJA

OBJEKTI – METODOLOGJIA

KONTEKSTI

GJETJE – REKOMANDIME


Komente nga bizneset, 2015-2018

- Pa një sistem rregulator transparent dhe profesional nuk mund të kemi **formalizim apo konkurrencë të ndershme....**
- Sektori ndërtimit - **mungojnë rregullat teknike**, ka ndërtime të mira, por ka edhe me cilësi të dobët, ndërkohë të dyja kategoritë pranojnë nga ata që bëjnë kolaudimin e objekteve....
- Në 27 vjet që Shqipëria është në ekonominë e tregut, mjaft investime *janë bërë për infrastrukturën por përsëri ne kemi rrugë me cilësi të dobët - Përse? Mungojnë filtrat e duhur dhe njerëzit me integritet.*
- Frenimi apo nxitja e investimeve - Informaliteti dhe konkurrenca e pandershme varen edhe Shteti dhe nga biznesi, **Inspektimet varen vetëm nga Institucionet...**
- AKU nuk kontrollon **subjektet e paregjistruara....**
- **Ka moskoordinim** midis inspektoriateve vendore dhe qendrore.
- Legalizimi i puseve të ujit (baza ligjore nuk ishte përfunduar) bëhet inspektimi dhe gjobë. Vendimi apelohej në inspektoriat dhe hedhur poshtë nga vetë Inspektoriati. Ndërkohë që leja për puse ka 8 muaj që pritet dhe nuk është dhënë akoma sa të mbledhet Këshilli i Baseneve....(viti 2017)
- Ka **shumë kërkesa dhe detyrime ligjore** për të qenë “në rregull” – (biznes i vogël)
- Çdo kontroll ka efekt pozitiv edhe po të jetë tendencioz, por në Shqipëri kontrollet do të gjejnë patjetër një shkelje sepse vetë **shteti nuk i zbaton njësoj rregullat.**
- Prodhuesi certifikon pajisjen me deklaratë konformiteti CE dhe për vendosjen në treg – a është subjekti në dijeni?
- Dogana akoma nuk ka laborator të akredituar?! (2016)
- Nëpër inspektoriate **mungojnë kapacitetet e duhura** teknike, njerëzore, memoria institucionale.


I. OBJEKTI I ANALIZËS

Të sjellë perceptimin e biznesit mbi faktorët kryesorë që influencojnë në mirëfunksionimin e tregut me fokus - transparenca dhe efikasiteti i inspektimeve, si edhe të parashtrojë rekomandime konkrete dhe konstruktive me synim përmirësimin e klimës së investimeve.

METODOLOGJIA



II. Perceptimi i Biznesit mbi Mirëfunksionimin e Tregut (2018)



Marrëdhënia dhe Roli i Administratës publike perceptohet nga 78% e bizneseve si faktor përcaktues në Mirëfunksionimin e Tregut, së bashku me nivelin e korrupsionit dhe konkurrencën e padrejtë.

II. KONTEKSTI- Dinamikat Strategjike & Rregullatore

**STRATEGJIA KOMBËTARE
BERIS 2007-2012**

**RISHIKIMI I KUADRIT
STRATEGJIK, LIGJOR DHE
INSTITUCIONAL TË
INSPEKTIMEVE**

**LIGJI NR. 10433, DATË 16.06.2011
“Për Inspektimin”**

Ligji i Inspektimit mundësoi:

1. Krijimi e IQ, si rregullator të aktivitetit të inspektoriateve;
2. Ndryshoi mënyrën e organizimit të inspektoriateve në nivel vendor dhe qendror;
3. Ligji centralizoi koordinimin rregullator dhe metodologjik të inspektimit, duke prezantuar e-inspektimet;
4. Vendosi disa garanci bazë mbi kohëzgjatjen e inspektimit “Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor është nga 5 deri në 15 ditë”;
5. Sanksionoi parimet bazë të inspektimit në funksion të uljes së barrës së biznesit.

II. KONTEKSTI

INSPEKTIMI SI MEKANIZEM MBIKQYRËS I NJË TREGU FUNKSIONAL

- Pikë takimi midis Administratës Publike dhe biznesit - profesionalizmi, korrupsioni, eficaenca etj
- Zbatimi i duhur i funksioneve inspektuese **kufizon informalitetin** dhe konkurrencën e padrejtë midis operatoreve në treg


INSPEKTIMET KONSIDEROHEN NJË ELEMENT THELBËSOR I DERREGULLIMIT

- Reformë e nisur mbi reduktimin e numrit të inspektimeve dhe rritjen e efikasitetit të tyre. **Statusi aktual i reformës?**

SFIDAT AKTUALE TË REFORMËS:

- *Përafrimi i legjislacionit sektorial me legjislacionin e BE-së*
- *Përmirësimi i kapaciteteve institucionale, burimeve njerëzore (veçanërisht teknike), logjistikës dhe kapaciteteve laboratorike (EU Progress Raporti 2019)*
- *Stabilizimi institucional*
- *Mirëfunksionimi i mekanizmave të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes biznesit dhe administratës publike*


II. KONTEKSTI – Dinamika e Inspektimeve 2013-2017



Trendi në rënie i numrit të inspektimeve

Përpjekje serioze (2007-2018) për të mos rritur kostot administrative të biznesit

II. Konteksti - Inspektoriatet me të atakuara në Gjykatën Administrative, 2018





- Inspektoriatet Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Sociale
- Inspektoriatet Shtetëror Shëndetësor
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
- Inspektoriatet Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit
- Inspektoriatet Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut
- Inspektoriatet Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
- Inspektoriatet Shtetëror Teknik dhe Industrial
- Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera

Inspektoriatet me numrin relativ më të madh të çështjeve rezultojnë **IKMT (40%), ISHPSHSH (23%), ISHMPUT(11%) dhe AKU (10%)**. Shpërndarja e çështjeve që kanë palë inspektoriatet, në gjykatën administrative të apelit, tregon për rritje të problematikave që kanë të bëjnë me **sigurinë ushqimore, mjedisin dhe ujërat**;

Marrëdhëniet e punës dhe siguria në punë gjithashtu janë çështje të rëndësishme për vëmendjen e inspektorateve dhe bizneseve. Rezulton se mesatarisht për të gjitha inspektoriatet 62% e çështjeve është fituar nga inspektoriatet dhe 38% e çështjeve të fituara nga bizneset.

II. Konteksti - Ankimimi Administrativ në Inspektoriате



Trend rënës i masave administrative
Raporti i gjobave vs. masave administrative në rritje

Vetëm 6% e masave administrative janë ankimuar në rrugë administrative pranë inspektoriатеve (mund të jetë çështje besimi, transparence, kosto, kohe, etj.).

III.GJETJE DHE REKOMANDIME – Qasja Strategjike

PROBLEMATIKA/GJETJE

- **Reforma e inspektimit. Cili është statusi i saj?** Sfidat aktuale të zbatimit të reformës së inspektimit kërkojnë një rigjallërim të angazhimit politik dhe dokumentave strategjike në koherencë me reformat në administratë.
- **Struktura institucionale** e inspektimit në Shqipëri ka ndryshuar rrënjësisht që nga viti 2010 dhe ende mbetet dinamike. **Në inspektim vihen re mbivendosje kompetencash** dhe funksionesh midis inspektoriateve të ndryshme.
- Prirja në **rënie i numrit të inspektimeve**, tregon se ka përpjekje për të krijuar një klimë pozitive biznesi. **Ndryshimet e shpeshta ligjore dhe institucionale**, vështirësojnë përputhshmërinë e biznesit.

REKOMANDIME

- Të përfundohet sa më parë vlerësimi i impaktit të deritanishëm të reformës së inspektimeve si mënyrë për të priorizuar hapat në të ardhmen dhe bërja e qartë e reformës në kuadrin e integritetit;
- Të institucionalizohet koordinimi ndër-institucional midis institucioneve me funksione inspektuese si mënyrë për të optimizuar impaktin pozitiv të reformës në klimën e biznesit dhe formalizimit të ekonomisë. Për këtë kërkohet:
 - ✓ *Angazhimi i qartë institucional i ministrive të linjës për të mbështetur inspektoriatet në ekzekutimin e funksioneve inspektuese.*
 - ✓ *Ulja eventuale e numrit të inspektoriateve dhe e bashkimit të funksioneve të tyre, të mos kushtëzojë zbatimin e funksioneve monitoruese dhe rregullatore.*
- Të forcohet dhe strukturohet komunikimi me biznesin në funksion të transparencës dhe përputhshmërisë. Ky konsultim të integrohet në mënyrë të strukturuar dhe të jetë pjesë e RIA-s, për të qartësuar efektet e pritshme të ndryshimeve rregullatore për biznesin.

III.GJETJE DHE REKOMANDIME – *Detyrime Ligjore*

PROBLEMATIKA/GJETJE

- **Dinamika e ligjeve dhe akteve nënligjore** në fushat e inspektimit vështirëson përputhshmërinë e bizneseve.
- **Numri i madh i bizneseve të vogla dhe me kapacitete të kufizuara**, si sfidë për përmbushjen e standardeve rregullatore dhe për ndërgjegjësimin e tyre.
- Praktikrat procedurale të inspektimit janë pothuajse të konsoliduara dhe të unifikuara në kuadër të e-inspektimit. **Vendimmarrja e inspektoriateve për të njejtat çështje inspektive për subjekte të ndryshme ka vend për përmirësim.**
- Pavarësisht numrit total në ulje të inspektimeve, **bizneset dhe vetë ISH raportojnë se kanë inspektive të shpeshta** dhe në kohë të ndryshme nga ISH të ndryshme dhe të pakoordinuara midis tyre. Barra e kontrolleve kryesisht tek bizneset e formalizuara.

REKOMANDIME

- Inventarizimi i plotë i kuadrit ligjor-rregullativ të inspektimit** dhe bërja lehtësisht i aksesueshëm për të gjitha grupet e interesit (biznese, shoqata, inspektorë).
- Asistencë ligjore falas dhe në distancë për subjektet e inspektimit nga ana e trupave inspektuese** nëpërmjet përgatitjes së manualeve të thjeshta për rubrika të veçanta, sipas tipologjive të inspektimit dhe karakteristikave të bizneseve. Fokusi i inspektimeve duhet të mbetet këshillimi dhe asistimi i bizneseve për të rritur përputhshmërinë e tyre me detyrimet ligjore.
- Konsolidimi i unifikimit të praktikave administrative të inspektimit nëpërmjet publikimit të komentareve.** Fokus ana teknike me trajnime, investime në literaturë, teknologji dhe aftësi testuese laboratorike.
- Të përmbushen detyrimet ligjore nga IQ për kryerjen e inspektimeve të planifikuara dhe të bashkërenduara midis inspektoriateve. **Përmirësimi i raportit midis inspektimeve të programuara dhe atyre të paprogramuara në raportet 85% me 15% (gjatë 2019).**

III.GJETJE DHE REKOMANDIME – *Detyrime Ligjore*

PROBLEMATIKA/GJETJE

- **Kritere vlerësimi jo të qarta dhe masa administrative administrative evazive të vendosura nga inspektorët e ISH.** Diskrecion i gjerë në dispozicion të vendimmarrjes së tyre, duke trajtuar në mënyra të ndryshme raste të njëjta apo të ngjashme.
- **Informacion i munguar ose i paplotë nga ana e ISH** mbi praktikat e ndjekura për vendosjen e masave administrative.
- **Listat e verifikimit për ISH janë përfunduar. Procesi për listë-verifikimet e inspektoriateve në nivel vendor ka nisur dhe mbetet të finalizohet.**

REKOMANDIME

- **Përgatitja/Përditësimi i metodologjive të riskut mbi bazën e të dhënave më të fundit të monitorimit sipas sektorëve do të rrisë efencën e inspektimeve dhe ulë barrën për bizneset;**
- **Miratimi i Rregullores së Përgjithshme mbi Metodologjinë e Vendosijes së Dënimeve Administrative dhe Metodologjitë përkatëse sipas inspektoriateve. Bërja publike dhe transparente e metodologjive të aplikuara nga inspektorët për vendosjen e dënimeve administrative proporcionale.**
- **Përfundimi i listë-verifikimeve për funksionet e inspektimit të inspektoriateve në nivel vendor dhe kryerja e inspektimeve online.**

III.GJETJE DHE REKOMANDIME – Kapacitete Institucionale/Ankimimi

PROBLEMATIKA/GJETJE

- Vetëm 6% e masave administrative të vendosura nga inspektoriatet janë ankimuar në rrugë administrative; Ndër masat administrative 64% kanë qënë gjoba;
- Mekanizmat e ankimit administrativ dhe të shqyrtimit të tyre në inspektoriate nuk janë ende të konsoliduara;
 - Strukturat e shqyrtimit të ankimeve nuk janë gjithmonë transparente;
 - Mungon informacioni i plotë, transparent dhe i sistemuar mbi vendimmarrjen e tyre.
 - Zbatimi i parimeve të KPrA për shqyrtimin e ankimeve është i kufizuar.
 - Ankimi administrativ konsiderohet në mjaft raste si një mekanizëm joefektiv nga bizneset.
- Biznesi por edhe drejtuesit e inspeksioneve shprehin se në inspektoriate ka **mungesë të kapaciteteve njerëzore të qëndrueshme, të trajnuara dhe të azhornuara me legjislacionin**; Burime të kufizuara për disa inspektoriate në raport me fushën e tyre të inspektimit.

REKOMANDIME

Të konsiderohet opsioni i centralizmit të mekanizmit të shqyrtimit të ankimeve administrative pranë Inspektoriatit Qendror.

- Unifikim i praktikave të konsoliduara mbi ankimin ndaj vendimeve të trupave të inspektimit.
- Zhvillimi i seancave dëgjimore gjatë shqyrtimit të ankimeve administrative duke përfshirë tre palët – ISH, biznesin dhe IQ.
- Rritet profesionalizmi dhe pavarësia e strukturave të shqyrtimit të ankimeve.
- Shërben si filtër për çështjet të cilat ankimohen në rrugë gjyqësore nga palët.
- Rrit shanset për trajtim të barabartë të bizneseve dhe për vetë-korrigjim të praktikave të vetë inspeksioneve.

Qëndrueshmëri dhe trajnimi i stafit të inspeksioneve. Motivimi i trupave inspektuese, testimi periodik i tyre dhe vlerësimi i performancës mbi kritere të mirëpërcaktuara; Mbështetje financiare dhe në burime njerëzore sipas fushës së veprimit.

MUND TË PËRFUNDOJMË:

Reforma e inspektimit – kërkon një rivitalizim të vendimmarrjes politike dhe institucionalizim të koordinimit të të gjithë aktorëve për të ecur drejt reformimit përmbajtësor të inspektimit (sektorët prioritarë). Vijueshmëri në përmirësimin e kuadrit ligjor sektorial dhe të akteve nënligjore, rregulloreve dhe praktikave të inspektimit në koherencë me axhendën e integritetit evropian.

Koordinim institucional, shmangie e mbivendosjes së kompetencave do sjellin optimizimin e ndikimit të kësaj reforme në formalizimin e ekonomisë dhe përmirësimin e klimës së biznesit.

Komunikimi dhe transparenca/konsultimi me palët e interesit, sidomos me bizneset duhet standartizuar që në hapat e parë, në mënyrë që të sigurohet sukses i reformës për të gjitha palët.

FALEMINDERIT!

www.investment.com.al